



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.145

20 tetor

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 150 datë 28.9.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së themelimit të Korporatës Islamike për Sigurimin e Investimeve dhe të Kredive të Eksportit”	6535
Ligj nr.10 151 datë 28.9.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin ndërkufitar Shqipëri- Mali i Zi, për vitin 2008, të komponentit të dytë të instrumentit të paraaderimit, IPA - bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë”	6555
Vendim i Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009	Për caktimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Kuvendit	6564
Vendim i Kuvendit nr.4, datë 16.9.2009	Për zgjedhjen e zëvendëskryetarëve, byrosë dhe përbërjen e sekretariateve të Kuvendit	6566

LIGJ
Nr.10 150, datë 28.9.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË THEMELIMIT TË KORPORATËS
ISLAMIKE PËR SIGURIMIN E INVESTIMEVE DHE TË KREDIVE TË EKSPORTIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e themelimit të Korporatës Islamike për Sigurimin e Investimeve dhe të Kredive të Eksportit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6285, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**NENET E MARRËVESHJES SË
KORPORATËS ISLAMIKE PËR SIGURIMIN
E INVESTIMEVE DHE KREDISË SË EKSPORTIT**

(Anëtar i Grupit të Bankës Islamike për Zhvillim)
SHABAN 1412/ SHKURT 1992G

Shtetet palë në këtë Marrëveshje dhe Banka Islamike për Zhvillim,
duke pasur parasysh një nga objektivat e Organizatës së Konferencës Islamike, siç shprehet në Kartën e Organizatës, është zhvillimi dhe mbështetja e bashkëpunimit ndërmjet vendeve anëtare në fushat ekonomike dhe sociale;

me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet ekonomike ndërmjet vendeve të Organizatës së Konferencës Islamike mbi bazën e parimeve dhe ideve islamike;

në përpjekje për të nxitur rrjedhën e kapitalit dhe për të zgjeruar kuadrin e marrëdhënieve tregtare, me qëllim që të forcohen dhe nxiten përpjekjet e tyre për zhvillim;

duke pasur parasysh:

a) nenin 15 të Marrëveshjes për nxitjen, mbrojtjen dhe garancinë e investimeve ndërmjet vendeve anëtare të Organizatës së Konferencës Islamike, që parashikon që Organizata, nëpërmjet Bankës Islamike për Zhvillim, themelon një institucion islamik për garancinë e investimeve për të ndërmarrë, në pajtim me Sheriahun (ligji islamik), dhënien e garancisë për investime në territoret e palëve nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje;

b) rekomandimin e komitetit të përhershëm për bashkëpunim tregtar dhe ekonomik (COMCEC) të Organizatës së Konferencës Islamike në sesionin e tij të pestë të mbajtur në Stamboll, Republikën e Turqisë, në Safar 1410H, për krijimin e mekanizmit për zbatimin e tij, në pajtim me Sheriahun, sigurimin e kredisë së eksportit, me qëllim që të mbrohen transaksionet ndërmjet vendeve islamike kundër risqeve tregtare dhe jotregtare,

kanë rënë dakord si më poshtë.

KAPITULLI I
THEMELIMI, PËRKUFIZIME, STATUSI, ZYRA, OBJEKTIVI DHE QËLLIMET,
ANËTARËSIA

Neni 1
Themelimi

Në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është themeluar një korporatë filiale e Bankës Islamike për Zhvillim e quajtur “Korporata Islamike për Sigurimin e Investimeve dhe Kredisë dhe Eksportit” (këtu quhet Korporata).

Neni 2
Përkufizime

Në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, fjalët dhe termat e mëposhtëm kanë kuptimet e mëposhtme:

“Organizata”, Organizata e Konferencës Islamike.

“Banka”, Banka Islamike për Zhvillim.

“Shtet(e) anëtar”, një shtet anëtar i Organizatës që është bërë palë në këtë Marrëveshje.

“Anëtar(ë)”, Banka dhe shteti(et) anëtare.

“Kredi e eksportit”, një kredi në lidhje me transaksionet e eksportit.

“Vendi pritës”, një shtet anëtar në territorin e të cilit gjendet një investim që është siguruar ose risiguruar, ose që konsiderohet për sigurim ose risigurim nga Korporata, ose një shtet në territoret e të cilit importohen mallra ose shërbime të financuara nga kredia e eksportit që është siguruar ose risiguruar ose konsiderohet për sigurim ose risigurim, nga Korporata¹.

“Sigurim i investimeve”, mbulimi i sigurimeve që jepet nga Korporata për investimet e përmendura në nenin 17 kundër risqeve të parashikuara në nenin 19(2) ose risqet e miratuara për mbulimin nga bordi i drejtorëve në pajtim me nenin 19(3).

“Investitorët e përshtatshëm”, një shtet anëtar ose një person fizik ose juridik që në bazë të nenit 18 është i përshtatshëm për të marrë shërbimet e sigurimit ose risigurimit të Korporatës në lidhje me investimet në një shtet anëtar².

“Sigurim i kredisë së eksportit”, mbulim me sigurim që jepet nga Korporata për kreditë e eksportit kundër risqeve të parashikuara në nenin 19(1) dhe 19(2) ose risqet e aprovuara për mbulim nga bordi i drejtorëve në pajtim me nenin 19(3).

“Kontratë(a) të sigurimit” përfshin kontratat e sigurimit të investimeve, si dhe kontratat e sigurimeve të kredive të eksportit.

“Kontratë(a) të risigurimit” përfshin mbulimin e risigurimit që jepet nga Korporata në lidhje me kontratat e sigurimit, si dhe kontratat e risigurimit që lidhen nga Korporata për cedimin e risqeve të siguruara ose risiguruara nga Korporata.

“Zotërues të policave”, personi ose personat juridikë ose fizikë që lidhin kontrata sigurimi me Korporatën në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

“Vendi i zotëruesit të policës”, shteti, legjislacionit të të cilit i nënshtrohet zotëruesi i policës³.

“Bordi i guvernatorëve”, bordi i guvernatorëve të Korporatës.

“Bordi i drejtorëve”, bordi i drejtorëve të Korporatës.

“Presidenti”, Presidenti i Korporatës.

“Dinar islamik”, njësia e llogarisë së Korporatës, vlera e të cilit është e barasvlershme me një të drejtë të veçantë tërheqjeje të Fondit Monetar Ndërkombëtar.

¹ Ndryshuar më 11 Shaban 1421H që përputhet me 7 nëntor 2000G.

² Ndryshuar më 17 Jumada Awwal 1426H që përputhet me 24 qershor 2005G.

³ Ndryshuar më 11 Shaban 1421H që përputhet me 7 nëntor 2000G.

Neni 3 Statusi

Pa cenuar dispozitat e nenit 1, Korporata është një institucion ndërkombëtar me personalitet të plotë juridik dhe veçanërisht me zotësinë:

- a) për të kontraktuar;
- b) për të përfutur dhe disponuar pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme; dhe
- c) për të filluar procedime ligjore.

Neni 4 Zyra e Korporatës

1. Zyra kryesore e Korporatës gjendet në qytetin Jeddah, Mbretëria e Arabisë Saudite.
2. Korporata mund të themelojë agjenci ose zyra degësh gjetkë.

Neni 5 Objektivi dhe qëllimet

1. Objektivi i Korporatës është zgjerimi i gamës së transaksioneve tregtare të shteteve anëtare dhe inkurajimi i fluksit të investimeve në shtetet anëtare⁴.

2. Për të arritur objektivin e saj, Korporata, në pajtim me parimet e Sheriahut, bën sigurimin dhe risigurimin e kredive të eksportit në lidhje me mallrat që përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 16, duke i paguar zotëruesit të policës një kompensim të arsyeshëm në lidhje me humbjet që rrjedhin nga risqet e përcaktuara në nenet 19(1) dhe 19(2), ose risqet e përcaktuara nga bordi i drejtorëve në pajtim me nenin 19(3).

3. Në një moment të përshtatshëm pas themelimit të saj, Korporata, në pajtim me parimet e Sheriahut, bën sigurimin e investimeve, si dhe risigurimin në lidhje me investimet në vendet anëtare nga investitorët e përshtatshëm kundër risqeve të përcaktuara në nenin 19(2) ose risqet e përcaktuara nga bordi i drejtorëve në pajtim me nenin 19(3)5.

4. Korporata ushtron ato kompetenca që ajo mund t'i mendojë të nevojshme ose të përshtatshme për arritjen e objektivave të saj. Korporata në të gjitha vendimet e saj u nënshtrohet dispozitave të këtij neni.

Neni 6 Anëtarësia

1. Anëtarët themelues janë banka dhe ato shtete anëtare të Organizatës të renditura në aneksin "A" që, në ose pas datës së përcaktuar në nenin 61, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje dhe kanë përmbushur të gjitha kushtet e tjera të anëtarësisë.

2. Çdo shtet tjetër që është një anëtar i Organizatës mund të bëjë kërkesë dhe të pranohet si anëtar pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje me ato terma dhe kushte që mund të vendoset me votën e shumicës së numrit të përgjithshëm të guvernatorëve që përfaqësojnë një shumicë të fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve.

3. Një shtet që është anëtar i Organizatës mund të autorizojë çdo subjekt ose agjenci për ta nënshkruar këtë Marrëveshje në emër të tij dhe ta përfaqësojë atë në të gjitha çështjet, në lidhje me këtë Marrëveshje me përjashtim të çështjeve të përmendura në nenin 62.

⁴ Ndryshuar më 17 Jumada Awwal 1426H që përputhet me 24 qershor 2005G.

⁵ Ndryshuar më 17 Jumada Awwal 1426H që përputhet me 24 qershor 2005G.

KAPITULLI II BURIMET FINANCIARE

Neni 7

Burimet e Korporatës

Burimet e Korporatës përbëhen nga:

- a) pajtimet në kapitalin e Korporatës;
- b) kontributet e sigurimeve dhe risigurimeve të dhëna nga zotëruesit e policave në Korporatë në masën e kërkuar nga Korporata për të mbuluar detyrimet;
- c) shumat dhe sende pasurore të tjera mbi të cilat Korporata fiton të drejtat si zëvendësuese pas shlyerjes së detyrimeve; dhe
- d) të ardhurat nga investimet e burimeve të Korporatës.

Neni 8

Kapitali i autorizuar

1. Kapitali i autorizuar i Korporatës është njëqind milionë (100 000 000) dinarë islamikë të ndarë në njëqind mijë (100 000) aksione që kanë vlerë nominale të barabartë me një mijë (1000) dinarë islamikë secili, që ofrohen për pajtim nga anëtarët në pajtim me dispozitat e nenit 9.

2. Kapitali i autorizuar mund të rritet nga bordi i guvernatorëve, në atë moment dhe me ato terma dhe kushte që mund t'i duket i përshtatshëm, me një votë prej dy të tretave e numrit të përgjithshëm të guvernatorëve, që përfaqësojnë jo më pak se tre të katërtat e fuqisë votuese të anëtarëve.

Neni 9

Pajtimi dhe caktimi i aksioneve

1. Banka do të nënshkruajë pesëdhjetë mijë (50 000) aksione në kapitalin e Korporatës që paguhet në pajtim me nenin 10(1).

2. Çdo shtet anëtar do të nënshkruajë në kapitalin e Korporatës dhe numri minimal i aksioneve që do të nënshkruajë një shtet anëtar është (250) dyqind e pesëdhjetë aksione.

3. Çdo shtet anëtar deklaron numrin e aksioneve që do të nënshkruajë në kapital para skadimit të datës së përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 61.

4. Pa cenuar paragrafin 2 të këtij neni, një shtet i pranuar për anëtarësim, në pajtim me paragrafin 2 të nenit 6, do të nënshkruajë numrin e aksioneve të pjesës së papajtuar të kapitalit të Korporatës që përcaktohet nga bordi i guvernatorëve.

5. Nëse bordi i guvernatorëve përcakton që është autorizuar një rritje në kapital, secili anëtar ka një mundësi të arsyeshme për të pajtuar, me ato terma dhe kushte që përcaktohen nga bordi i guvernatorëve, në raport me rritjen e aksioneve, që është i barabartë me raportin që aksionet e tij kishin më parë; me kusht që dispozita e mësipërme nuk zbatohet në lidhje me rritjen ose një pjesë të rritjes në kapital të destinuar vetëm për t'i dhënë fuqi përcaktimit të bordit të guvernatorëve, sipas paragrafëve 4 dhe 6 të këtij neni. Asnjë anëtar nuk është i detyruar të nënshkruajë ndonjë pjesë të rritjes së kapitalit.

6. Bordi i guvernatorëve, me kërkesë të një anëtari, me votën e një shumice të të gjithë numrit të guvernatorëve që përfaqësojnë një shumicë të fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve, mund të rrisin pajtimin e këtij anëtari në kapitalin e Korporatës me ato kushte dhe terma që mund të përcaktohen nga bordi.

7. Aksionet e kapitalit të pajtuara nga anëtarët themelues emetohen me vlerë nominale. Çdo anëtar tjetër nënshkruan atë numër aksionesh në kapital me ato kushte dhe terma që mund të përcaktohen nga bordi i guvernatorëve, por në asnjë rast me një çmim emetimi më të vogël se nominali.

Neni 10

Pagesa e aksioneve të pajtuara

1. Pagesa e shumës së pajtuar nga Banka në kapitalin e Korporatës bëhet në një monedhë të konvertueshme në Korporatë brenda 30 ditëve pas datës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi.

2. Pagesa e vlerës së aksioneve, të pajtuara nga shtetet anëtare themeluese, bëhet si më poshtë:

a) pesëdhjetë për qind (50%) e vlerës së secilit aksion paguhet me para në dorë në një monedhë të konvertueshme të pranueshme nga Korporata në dy këste të barabarta, ku i pari paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve pas datës së depozitimit, në emër të shtetit anëtar përkatës, të instrumentit të ratifikimit ose pranimit; dhe kësti i dytë paguhet brenda një periudhe që nuk e kalon dymbëdhjetë muaj pas pagesës së kështit të parë;

b) pjesa e mbetur e pajtimeve të papaguara i nënshtrohet ftesës nga Korporata, në një monedhë lirisht të konvertueshme, të pranueshme për Korporatën, ashtu si dhe kur të kërkohet për të përmbushur detyrimet e saj;

c) ftesës për çdo pjesë të pajtimeve të papaguara janë uniforme për të gjitha aksionet;

d) nëse shuma e pranuar nga Korporata pas një ftese është e pamjaftueshme për të përmbushur detyrimet që kanë bërë të nevojshme ftesën, Korporata mund të bëjë ftesa të tjera pasuese për pajtimet e papaguara, derisa shuma e përgjithshme e marrë prej saj të jetë e mjaftueshme për t'i përmbushur këto detyrime.

3. Korporata përcakton vendin për çdo pagesë në bazë të këtij neni. Derisa të përcaktohet kjo, pagesa e pjesës së vlerës së aksioneve të përmendura në paragrafin 2(a) bëhet në ato vende që mund të përcaktohen nga Banka.

Neni 11

Rimbursimet

1. Korporata, menjëherë sapo të jetë e mundur, u kthen shteteve anëtare shumat e paguara në ftesat për kapitalin e pajtuar, nëse dhe në masën që:

a) thirrja është bërë për të paguar për një detyrim që rrjedh nga një kontratë sigurimi ose risigurimi që nuk mund të përmbushej nga sendet pasurore të fondit të zotëruesve të policave dhe pas kësaj Korporata ka përfutur, plotësisht ose pjesërisht, në një monedhë të konvertueshme, shumën e këtij detyrimi; ose

b) thirrja është bërë për shkak të një vonesë në pagesë nga një shtet anëtar dhe pas kësaj ky shtet anëtar e ka korrigjuar vonesën plotësisht ose pjesërisht; ose

c) bordi i guvernatorëve, me votën e jo më pak se dy të tretat e fuqisë së përgjithshme të votimit, përcakton që gjendja financiare e Korporatës lejon kthimin e një pjese ose të gjithë shumës.

2. Çdo rimbursim i realizuar sipas këtij neni për një shtet anëtar bëhet në një monedhë lirisht të konvertueshme në raport me pagesat e bëra nga shteti anëtar në shumën e përgjithshme të paguar në pajtim me ftesat e bëra para këtij rimbursimi.

3. Ekuivalenti i shumave të rimbursuara sipas këtij neni të një shteti anëtar bëhet pjesë e detyrimeve kapitale të shtetit anëtar që mund të thirret sipas nenit 10(2) (b).

Neni 12

Kushtet në lidhje me kapitalin

1. Aksionet e kapitalit nuk mund të lihen peng apo të rëndohen me barrë në çdo mënyrë dhe ato nuk janë të transferueshme, përveçse Korporatës në pajtim me kapitullin VI.

2. Detyrimi i një anëtar, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, kufizohet në pjesën e papaguar të pajtimit në kapital.

3. Asnjë anëtar, për shkak të vetëm të anëtarësisë së tij, nuk është i detyruar për detyrimet e Korporatës kundrejt palëve të treta.

Neni 13

Detyrimet dhe të drejtat e kapitalit

1. Shpenzimet e themelimit paguhen nga kapitali nëpërmjet një huaje që shlyhet nga shtesa e mbledhur në fondin e zotëruesve të policave.
2. Kapitali nuk ka të drejtën e asnjë aksioni në shtesat që i mblihen fondit të zotëruesve të policave.
3. Çdo deficit në fondin e zotëruesve të policave mbulohet nga kapitali nëpërmjet një huaje që shlyhet nga shtesat që mblihen në fondin e zotëruesve të policave.

KAPITULLI III

OPERACIONET E KORPORATËS

Neni 14

Përdorimi i burimeve

Burimet dhe ambientet e Korporatës përdoren përjashtimisht për të arritur objektivat dhe qëllimet e Korporatës të parashikuara në nenin 5.

Neni 15

Rregullat në lidhje me operacionet

1. Në përmbushjen e operacioneve të saj, Korporata:
 - a) përpiket të arrijë bashkëpunim reciprok të zotëruesve të policave nëpërmjet mbulimit të përbashkët të humbjeve që mund të pasojë një zotërues policash, i caktuar me materializimin e riskut ose risqeve të siguruara ose risiguruara nga Korporata;
 - b) u shpërndan zotëruesve të policave shtesën që mund të mblihet nga operacionet e sigurimit ose risigurimit mbi bazën që mund të përcaktohet nga bordi i guvernatorëve;
 - c) i kushton vëmendjen e duhur ruajtjes së gjendjes së shëndoshë financiare në pajtim me praktikën e vendosura të biznesit.
2. Përveç kur kërkohet ndryshe nga konteksti, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje që zbatohen në transaksionet e sigurimeve zbatohen në transaksionet e risigurimeve që kryhen nga Korporata.

Neni 16

Kreditë e eksporteve të përshtatshme për sigurime⁶

Të gjitha eksportet e kredive që u takojnë mallrave që eksportohen nga një shtet anëtar në një shtet tjetër anëtar janë të përshtatshme për sigurim, me kusht që:

1. Mallrat, objekt i kredisë, të jenë prodhuar plotësisht ose pjesërisht, montuar ose ripërpunuar në një ose më shumë shtete anëtare, me kusht që një vlerë e arsyeshme e shtuar i shtohet shtetit anëtar nga i cili këto mallra eksportohen. Bordi i drejtorëve, herë pas here, nxjerr rregullore që përcakton llojet dhe specifikimet e mallrave në lidhje me të cilat Korporata mund të sigurojë kredi eksporti dhe vlerën minimale që duhet t'i shtohet shtetit anëtar në të cilin këto mallra janë prodhuar, ripërpunuar ose montuar.
2. Kohëzgjatja e kredisë nuk i kalon pesë vjet, përveç kur bordi i drejtorëve vendos ndryshe.
3. Shërbimi e ka origjinën në një ose më shumë shtete anëtare, në pajtim me kushtet e përcaktuara nga bordi i drejtorëve.

⁶ Ndryshuar më 11 Shaban 1421H që përputhet me 7 nëntor 2000G.

Neni 17

Investimet e përshtatshme për sigurim

1. Investimet e përshtatshme për sigurim përmblendhin të gjitha investimet në shtetet anëtare nga investitorët e përshtatshëm duke përfshirë investimet e drejtpërdrejta në ndërmarrje, degët dhe agjencitë e tyre; investimet në kapitalin aksionar të ndërmarrjeve, duke përfshirë shumat principate të huave të dhëna ose garantuara nga zotëruesit e kapitalit të vet në ndërmarrjen përkatëse; dhe të gjitha format e tjera të investimeve të drejtpërdrejta që konsiderohen të përshtatshme për sigurim nga bordi i drejtorëve⁷.

2. Përveç transaksioneve të risigurimit, sigurimi kufizohet në investimet zbatimi i të cilave fillon pas regjistrimit të kërkesës për sigurim nga Korporata. Këto investime mund të përfshijnë:

a) transferimin e shkëmbimit të huaj të bërë për të modernizuar, zgjeruar ose zhvilluar investimet ekzistuese; dhe

b) përdorimi i fitimeve nga investimet ekzistuese që mund të transferoheshin jashtë vendit pritës.

3. Investimet private, publike dhe të përziera që operojnë ne bazë tregtare janë të përshtatshme për sigurim nga Korporata.

Neni 18

Përshtatshmëria për të marrë shërbimet e Korporatës⁸

1. Subjektet e mëposhtme janë të përshtatshme për të marrë sigurimet e sigurimeve dhe risigurimeve të Korporatës në lidhje me kreditin e eksportit:

a) Banka;

b) çdo person fizik që është shtetas i një shteti anëtar i ndryshëm nga vendi pritës; dhe

c) çdo person juridik, zyra kryesore e të cilit gjendet në një shtet anëtar, përveç rastit të mbulimit të shërbimeve, kur pjesa më e madhe e kapitalit dhe aksioneve duhet të jetë në pronësi të një ose disa shtetasve të një ose më shumë shteteve anëtare.

2. Në pajtim me dispozitat e nenit 16 dhe pavarësisht nga sa më sipër, një person juridik, nëpërmjet një rezolute të bordit të drejtorëve, mund të pranohet si palë në një kontratë sigurimi ose Risigurimi edhe nëse zyra e tij kryesore gjendet në një shtet joanëtar, me kusht që ky person juridik të jetë në pronësi, në jo më pak se pesëdhjetë për qind nga një ose më shumë anëtarë ose nga një ose disa shtetas të një ose më shumë shteteve anëtare ose nga persona juridikë që, në bazë të dispozitës së paragrafit I(C) të këtij neni, do të ishin palë të përshtatshme në një kontratë sigurimi ose risigurimi.

3. Banka dhe çdo person fizik ose juridik mund të jetë i përshtatshëm për të marrë shërbimet e Korporatës për sigurimet dhe risigurimet në lidhje me investimet në një shtet anëtar, me kusht që:

a) ky person fizik nuk është shtetas i vendit pritës;

b) ky person juridik nuk është themeluar ose ka vendin e tij kryesor të biznesit në vendin pritës ose shumica e kapitalit të të cilit është në pronësi të vendit pritës ose shtetasve të tij.

4. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 3 të këtij neni, bordi i drejtorëve mund të zgjerojë përshtatshmërinë për sigurim të një personi fizik që është një shtetas i vendit pritës ose një person juridik që është themeluar në vendin pritës ose shumica e kapitalit të të cilit është në pronësi të shtetasve të tij, me kusht që:

a) kërkesa për sigurim bëhet bashkërisht nga vendi pritës dhe kërkuesi i sigurimit; dhe

b) sendet pasurore që duhet të sigurohen janë ose do të jenë transferuar nga jashtë vendit pritës.

5. Nëse kërkuesi për sigurim ka më shumë se një shtetësi, shtetësia e një shteti anëtar mbizotëron mbi shtetësinë e një joanëtari, dhe shtetësia e vendit pritës mbizotëron mbi shtetësinë e çdo shteti tjetër anëtar.

⁷ Ndryshuar më 17 Jumada Awwal 1426H që përputhet me 24 qershor 2005G.

⁸ Ndryshuar më 17 Jumada Awwal 1426H që përputhet me 24 qershor 2005G.

Neni 19
Risqet e mbuluara

1. Korporata mund të mbulojë kreditë e përshtatshme të eksportit ndaj një humbjeje që rezulton nga një prej llojeve të mëposhtme të risqeve tregtare:

- a) paaftësia paguese ose falimentimi i blerësit;
- b) mosnjohja ose prishja e kontratës së blerjes nga blerësi ose refuzimi apo mosmarrja prej tij e furnizimit të mallrave pavarësisht përmbushjes së detyrimeve nga shitësi kundrejt blerësit;
- c) refuzimi i blerësit për t'ia paguar çmimin e blerjes shitësit ose moskryerja e kësaj pavarësisht përmbushjes së detyrimeve nga shitësi kundrejt blerësit.

2. Korporata mund të mbulojë kreditë e përshtatshme të eksportit, si dhe investimet e përshtatshme kundër humbjeve që rrjedhin nga një ose më shumë prej risqeve jotregtare të përcaktuara më poshtë:

- a) Transferimi i monedhës

Çdo prezantim nga ana e qeverisë së vendit pritës ose vendit të zotëruesit të policës së kufizimeve mbi transferimin jashtë vendit pritës ose vendit të zotëruesit të policës të monedhës përkatëse lokale në një monedhë lirisht të konvertueshme ose një monedhë tjetër që pranohet nga zotëruesi i policës, duke përfshirë refuzimin ose mosveprimin nga qeveria e vendit pritës ose vendit të zotëruesit të policës brenda një afati të arsyeshëm kohe në lidhje me një kërkesë nga ky zotërues police për këtë transferim; si dhe vendosja nga autoritetet publike të vendit pritës ose të vendit të zotëruesit të policës, në momentin e transferimit, e një kursi këmbimi që është diskriminues kundër zotëruesit të policës.

- b) Shpronësimi dhe masa të ngjashme

Çdo veprim legjislativ ose veprim apo mosveprim administrativ i qeverisë së vendit pritës ose vendi i zotëruesit të policës, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një agjencie, që ka efektin e heqjes për zotëruesin e policës të pronësisë ose kontrollit të investimit të tij ose të mallrave të shitura sipas një kredie eksporti, ose e një përfitimi thelbësor në lidhje me investimin përkatës ose të mallrave përkatëse, me përjashtim të masave jodiskriminuese të zbatimit të përgjithshëm që ndërmarrin qeveritë për qëllimin e rregullimit të aktivitetit ekonomik në territoret e tyre. Masat e referuara këtu përfshijnë revokimin nga vendi pritës i licencave të importit për mallrat, objektin e një kredie eksporti të siguruar nga Korporata, pasi të jenë dërguar mallrat; refuzimi i vendit pritës për të lejuar hyrjen e mallrave në territoret e tij; si dhe refuzimin e tranzitit të mallrave ose konfiskimin apo sekuestrimin e tyre nga një vend tranzit që është një anëtar i Korporatës.

- c) Shkelja e Kontratës

Çdo mosnjohje ose shkelje nga qeveria e vendit pritës ose e vendit të zotëruesit të policës të një kontrate me zotëruesin e policës, kur (a) zotëruesi i policës nuk ka të drejtën t'i drejtohet një organi gjyqësor ose arbitrazhi për të përcaktuar detyrimin e mosnjohjes ose shkeljes, ose (b) një vendim nga një organ i tillë nuk jepet brenda një periudhe të tillë të arsyeshme kohore që parashikohet në kontratat e sigurimit në pajtim me rregulloret e Korporatës; ose (c) një vendim i tillë nuk mund të ekzekutohet, dhe

- d) Luftë ose trazirë civile

Çdo veprim ushtarak ose trazirë civile në një territor të vendit pritës, të vendit të zotëruesit të policës ose në një vend tranzit që është anëtar i Korporatës.

3. Bordi i drejtorëve mund të aprovojë zgjerimin e mbulimit për risqe specifike tregtare ose jotregtare të ndryshme nga ato të parashikuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

- 4. Në asnjë rast nuk mbulohen humbjet që rrjedhin nga sa më poshtë:

- a) humbja ose rënia e vlerës së monedhës;
- b) çdo veprim ose mosveprim nga autoritetet e vendit pritës ose vendit të zotëruesit të policës për të cilin zotëruesi i policës ka rënë dakord ose për të cilën ai ka qenë përgjegjës, dhe
- c) çdo veprim ose mosveprim nga autoritetet e vendit pritës ose vendit të zotëruesit të policës, që ndodh para përfundimit të kontratës së sigurimit.

Neni 20

Kontratat e sigurimit dhe risigurimit

Korporata përgatit kontratat e sigurimit dhe të risigurimit në pajtim me rregullat dhe rregulloret që, herë pas here, mund të nxirren nga bordi i drejtorëve, me kusht që Korporata të mos mbulojë të gjithë humbjen e siguruar ose risiguruar.

Neni 21

Kufijtë e sigurimit

1. Përveç kur bordi i guvernatorëve, me shumicën e anëtarëve të tij që përfaqësojnë një shumicë të fuqisë votuese të anëtarëve, vendos ndryshe, shuma e përgjithshme e detyrimeve të paparashikuara që mund të merren përsipër nga Korporata nuk e kalon njëqind e pesëdhjetë për qind të shumës së kapitalit të pajtuar dhe të pacenuar të Korporatës dhe rezervave të saj, duke shtuar ato pjesë të mbulimit të risigurimit të tij që mund të përcaktohet nga bordi i drejtorëve. Bordi i drejtorëve, herë pas here, rishikon profilin e riskut të portofolios së Korporatës nën dritën e eksperiencës së saj me detyrimet, masën e shpërndarjes së risqeve, mbulimin e risigurimit dhe faktorë të tjerë përkatës me qëllim evidentimin nëse ndryshimet në shumën e përgjithshme maksimale të detyrimeve të paparashikuara duhet t'u rekomandohen bordit të guvernatorëve. Shuma maksimale e përcaktuar nga bordi i guvernatorëve në asnjë rrethanë nuk e kalon dhjetë herë shumën e kapitalit të pajtuar të paprekur të Korporatës, rezervat e saj dhe atë pjesë të mbulimit të risigurimeve të saj siç mund të jetë e nevojshme⁹.

2. Pa cenuar tavanin e përgjegjësisë të paparashikuara, të përmendura në paragrafin (1) të nenit, bordi i drejtorëve mund të parashikojë:

a) shumat e përgjithshme maksimale të detyrimeve të paparashikuara që mund të merren përsipër nga Korporata sipas të gjitha kontratave me një anëtar ose zotërues të policës të secilit shtet anëtar të veçantë. Bordi i drejtorëve i përcakton këto shuma maksimale nën dritën e aksioneve të anëtarit përkatës në kapitalin e Korporatës;

b) shumat e përgjithshme maksimale të detyrimeve të paparashikuara që mund të merren përsipër nga Korporata në lidhje me transaksione të veçanta.

Neni 22

Tarifa dhe kontribute

1. Korporata mbledh një tarifë për të mbuluar shpenzimet e shqyrtimit të një kërkesë për sigurim ose risigurim.

2. Korporata cakton normat e kontributeve, tarifave ose detyrimeve të tjera, sipas rastit, që zbatohen për çdo tip risku.

3. Korporata, herë pas here, mund të rishikojë normën e kontributeve, tarifave ose detyrimeve të tjera.

Neni 23

Pagesa e detyrimeve

Presidenti i Korporatës, në pajtim me ato udhëzime të përgjithshme që mund të nxirren nga bordi i drejtorëve, vendos mbi pagesën e detyrimeve ndaj zotëruesve të policave në pajtim me dispozitat e kontratës së sigurimit ose risigurimit, sipas rastit. Kontratat e sigurimit dhe risigurimit parashikojnë që zotëruesit e policave të kërkojnë, para se të bëhet pagesa nga Korporata, ato mjete

⁹ Sipas rezolutës së bordit të guvernatorëve nr. BG/IC/(4) 13/427, shuma maksimale e përgjithshme e detyrimeve të paparashikuara që mund të merren përsipër nga Korporata, është rritur shtatë qind e pesëdhjetë për qind të kapitalit të paprekur të Korporatës, rezervave të saj duke i shtuar pjesën e mbulimit të risigurimeve të saj.

administrative që mund të jenë të përshtatshme sipas rrethanave, me kusht që ato t'u ofrohen atyre sipas ligjeve të vendit pritës. Kontratat e sigurimit dhe risigurimit mund të kërkojnë kalimin e afateve të arsyeshme të caktuara ndërmjet ndodhjes së ngjarjeve që shkaktojnë lindjen e detyrimeve dhe pagesën e detyrimeve.

Neni 24 **Zëvendësimi**

1. Pas pagesës ose rënies dakord për t'i paguar kompensim një zotëruesi të policës, në lidhje me një humbje të siguruar, Korporata përfton ato të drejta ose pretendime në lidhje me sendet e siguruar që zotëruesi i policës mund të ketë pas materializimit të riskut përkatës. Kontratat e sigurimit përcaktojnë me hollësi kufijtë brenda të cilëve Korporata përfton të drejtat e zotëruesit të policës.

2. Të drejtat e Korporatës në pajtim me paragrafin 1 njihen nga të gjithë anëtarët e saj.

3. Si pasojë e përftimit nga Korporata e të drejtave të një zotëruesi të policës, në pajtim me paragrafin 1, vendet pritëse ose vendet e zotëruesve të policave, sipas rastit, i shlyejnë Korporatës sa më shpejt të jetë e mundur të gjitha detyrimet e tyre kundrejt zotëruesit të policave dhe, me kërkesë të Korporatës, i krijojnë Korporatës të gjitha mundësitë e përshtatshme për të përfituar nga të drejtat e përftuara për shkak të zëvendësimit. Pa cenuar sa më sipër, shumave në monedhën e vendit pritës ose të vendit të zotëruesit të policës, të përftuara nga Korporata si zëvendësuese në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, u jepet, në lidhje me përdorimin dhe konvertimin, një trajtim nga vendi përkatës aq i favorshëm sa dhe trajtimi për të cilën këto fonde do t'i ishin dhënë në dorë zotëruesit të policës.

Neni 25 **Bashkëpunimi me subjektet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare të sigurimit dhe risigurimit**

Pa cenuar nenin 5:

1. Korporata mund të hyjë në marrëveshje me sigurues dhe risigurues kombëtarë privatë dhe publikë në shtetet anëtare për të forcuar aktivitetin e saj dhe t'i inkurajojë këto subjekte për të mbuluar risqe tregtare dhe jotregtare me kushtet e ngjashme me ato të zbatuara nga Korporata. Këto marrëveshje mund të përfshijnë dhënien e shërbimeve të risigurimit nga Korporata për këto subjekte.

2. Korporata mund të bashkëpunojë me subjekte të ngjashme kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në çdo mënyrë që mund të konsiderohet e përshtatshme për qëllimet e Korporatës.

3. Korporata mund të risigurojë me çdo subjekt të përshtatshëm risigurimi, plotësisht ose pjesërisht, çdo kredi eksporti ose investim të siguruar prej saj.

KAPITULLI IV **DISPOZITA FINANCIARE**

Neni 26 **Menaxhimi financiar**

1. Bordi i drejtorëve nxjerr rregulla dhe rregullore financiare që janë të nevojshme për biznesin e Korporatës*

2. Viti financiar i Korporatës është Viti Hijra.

Neni 27
Llogaritë

Korporata publikon dhe qarkullon tek anëtarët një raport vjetor mbi llogaritë e saj të audituara nga auditues të pavarur.

Neni 28
Fondet

1. Korporata mban dhe administron dy fonde të veçanta;
 - a) një fond të zotëruesve të policave, dhe
 - b) një fond të aksionarëve.
2. Sendet pasurore të fondit të zotëruesve të policave përbëhen nga:
 - a) kontributet e sigurimit dhe risigurimit dhe tarifat e mbledhura;
 - b) detyrimet e mbledhura nga risigurimet;
 - c) shtesa që mund të mblidhen nga operacionet e Korporatës;
 - d) rezervat e mbledhura duke veçuar pjesë të shtesës së përmendur në paragrafin (c);
 - e) fitimet e realizuara nga investimet e rezervave që i takojnë fondit të zotëruesve të policave;
 - f) pjesa e fitimit nga investimet e fondit të zotëruesve të policave që i shtohet fondit të zotëruesve të policave në cilësinë si Mudarib (fond në formë kapitali);
 - g) shumat e përftuara nga Korporata si zëvendësuese pas kompensimit të zotëruesve të policave.
3. Sendet pasurore të fondit të aksionarëve përbëhen nga:
 - a) kapitali i paguar, si dhe rezervat që i takojnë fondit të aksionarëve;
 - b) fitimet nga investimet e kapitalit të paguar dhe rezervat që i takojnë fondit të aksionarëve.

Neni 29
Rezervat dhe alokimi i të ardhurave neto

1. Bordi i guvernatorëve ua alokon të gjithë shtesën që i shtohet fondit të zotëruesve të policave dhe të gjitha fitimet që i shtohen fondit të aksionarëve rezervave, derisa këto rezerva të arrijnë pesë herë kapitalin e pajtuar të Korporatës.
2. Pasi rezervat të kenë arritur nivelin e parashikuar në paragrafin 1 më sipër, bordi i guvernatorëve vendos nëse dhe në cilën masë:
 - a) shtesa që i shtohet fondit të zotëruesve të policave mund t'u alokohet rezervave ose u shpërndahet zotëruesve të policave;
 - b) të ardhurat neto që i shtohen fondit të aksionarëve mund t'u alokohen rezervave të fondit të aksionarëve, u shpërndahet anëtarëve të Korporatës ose përdoren ndryshe. Çdo shpërndarje e të ardhurave neto tek anëtarët e Korporatës bëhet në raport me pjesën e çdo anëtari në kapitalin e Korporatës.

Neni 30
Buxheti

Presidenti përgatit dhe paraqet buxhetin vjetor të Korporatës për aprovim nga bordi i drejtorëve.

Neni 31
Përcaktimi i normave të këmbimit dhe konvertueshmëria

1. Përcaktimi i normave të këmbimit në raport me dinarin islamik ose zgjidhja e çdo çështjeje në lidhje me normat e këmbimit bëhen nga Korporata mbi bazën e normave të deklaruara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

2. Kurdoherë që sipas kësaj Marrëveshjeje del nevoja për të përcaktuar nëse një monedhë është lirisht e konvertueshme, ky përcaktim bëhet nga Korporata që mund të konsultohet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, nëse ajo e konsideron këtë të nevojshme.

Neni 32

Përdorimi dhe konvertimi i monedhave

Pa cenuar dispozitat e nenit 24:

1. një shtet anëtar nuk mban apo vendos ndonjë kufizim mbi marrjen, mbajtjen ose përdorimin e monedhës së tij, ose ndonjë monedhe tjetër, në llogarinë e Korporatës;

2. një shtet anëtar, me kërkesë të Korporatës, lehtëson konvertimin e menjëhershëm të monedhës së tij të mbajtur nga Korporata në një monedhë lirisht të konvertueshme mbi bazën e normave të këmbimit të përcaktuar për datën e vlerës së konvertimit në pajtim me nenin 31;

3. monedhat e shteteve joanëtare të mbajtura nga Korporata nuk përdoren për të blerë monedhën e një shteti anëtar, përveç se në rrjedhën normale të biznesit të Korporatës ose me aprovimin e shtetit anëtar përkatës;

4. një shtet anëtar nuk vendos asnjë kufizim mbi dërgimin e shumave të kërkueshme nga Korporata në monedhë të konvertueshme të pranueshme nga Korporata.

KAPITULLI V

ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

Neni 33

Struktura e Korporatës

Korporata ka një bord guvernatorësh, një bord drejtorësh, një president, një menaxher dhe nëpunës dhe personel tjetër që mund të jetë i nevojshëm për të përmbushur detyrat që mund të caktohen nga Korporata.

Neni 34

Bordi i guvernatorëve: përbërja

1. Bordi i drejtorëve përbëhet nga guvernatorët dhe zëvendësguvernatorët e Bankës. Kryetari i bordit të guvernatorëve të Bankës do të jetë kryesisht kryetari i bordit të guvernatorëve të Korporatës.

2. Guvernatorët dhe zëvendësguvernatorët shërbejnë si të tillë pa shpërblim nga Korporata, por Korporata mund t'i rimbursojë ata për shpenzimet e arsyeshme që shkaktohen nga pjesëmarrja në mbledhje.

Neni 35

Bordi i guvernatorëve: kompetencat

1. Të gjitha kompetencat e Korporatës i vishen bordit të drejtorëve.

2. Bordi i guvernatorëve mund t'i delegojë bordit të drejtorëve çdo dhe të gjitha kompetencat, përveç kompetencës për të:

- a) pranuar anëtarë të rinj dhe përcaktuar kushtet për pranimin e tyre;
- b) shtuar ose pakësuar kapitalin e autorizuar të Korporatës;
- c) pezulluar një anëtar;
- d) vendosur për ankimet nga interpretimet ose zbatimet e kësaj Marrëveshjeje, të dhëna nga bordi i drejtorëve;
- e) përcaktuar rezervën dhe shpërndarjen e të ardhurave neto dhe shtesës së Korporatës;
- f) ndryshuar këtë Marrëveshje;
- g) vendosur të pushojnë operacionet e Korporatës dhe të shpërndajnë sendet pasurore të saj;

- h) përcaktuar shpërblimin e drejtorëve;
- i) ushtruar kompetenca të tjera të veçanta që i janë caktuar shprehimisht bordit të guvernatorëve në këtë Marrëveshje.

3. Bordi i guvernatorëve dhe bordi i drejtorëve në masën e autorizuar, mund të miratojnë ato rregulla dhe rregullore që mund të jenë të nevojshme ose të përshtatshme për të zhvilluar biznesin e Korporatës duke përfshirë rregullat dhe rregulloret që i takojnë personelit, daljes në pension dhe përfitimeve të tjera. Derisa të miratohen këto rregulla dhe rregullore, rregullat, rregulloret dhe aktet nënligjore të Bankës, në masën që ato janë në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, zbatohen për Korporatën sikur këto të jenë miratuar nga bordi i guvernatorëve, ose bordi i drejtorëve në masën e autorizuar sipas kësaj Marrëveshjeje.

4. Bordi i guvernatorëve mban kompetencë të plotë për të ushtruar autoritetin mbi çdo çështje të deleguar bordit të drejtorëve sipas paragrafëve 2 dhe 3 të këtij neni.

Neni 36

Bordi i guvernatorëve: procedura

1. Bordi i guvernatorëve mban një mbledhje vjetore dhe çdo mbledhje tjetër që mund të konsiderohet e nevojshme nga bordi i guvernatorëve ose që thirret nga bordi i drejtorëve. Mbledhjet e bordit të guvernatorëve thirren nga bordi i drejtorëve kurdoherë që kërkohet nga Banka ose nga një e treta e shteteve anëtare.

2. Mbledhja vjetore e bordit të guvernatorëve të Korporatës mbahet së bashku me mbledhjen vjetore të bordit të guvernatorëve të Bankës.

3. Një shumicë e guvernatorëve përbën kuorumin për çdo mbledhje të bordit të guvernatorëve të Korporatës, me kusht që kjo shumicë të përfaqësojë jo më pak se dy të tretat e fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve.

4. Bordi i guvernatorëve vendos me rregullore një procedurë nëpërmjet së cilës bordi i drejtorëve, nëse ky i fundit e konsideron këtë veprim të këshillueshëm, mund të marrë një votë të guvernatorëve për një çështje specifike pa thirrur një mbledhje të bordit të guvernatorëve.

Neni 37

Bordi i drejtorëve: përbërja

1. Bordi i drejtorëve ekzekutivë të Bankës është bordi i drejtorëve të Korporatës.

2. Të gjitha rregulloret, aktet nënligjore dhe procedurat e bordit të drejtorëve ekzekutivë të Bankës bëjnë kërkesë te bordi i drejtorëve të Korporatës sikur këta të fundit të jenë bordi i drejtorëve ekzekutivë të Bankës.

Neni 38

Bordi i drejtorëve: kompetencat

Bordi i drejtorëve është përgjegjës për drejtimin e operacioneve të përgjithshme të Korporatës dhe, për këtë qëllim, përveç kompetencave të caktuara shprehimisht nga kjo Marrëveshje, ushtron të gjitha kompetencat e deleguara nga bordi i guvernatorëve dhe veçanërisht:

- 1. përgatit punën e bordit të guvernatorëve;
- 2. vendos udhëzime për zhvillimin biznesit të Korporatës dhe operacioneve të saj në pajtim me udhëzimet e përgjithshme të bordit të guvernatorëve, dhe
- 3. aprovon buxhetin e Korporatës.

Neni 39

Bordi i drejtorëve: procedura

1. Bordi i drejtorëve funksionon në zyrën kryesore të Korporatës, përveç kur vendoset ndryshe nga Banka dhe mblidhet sa herë mund ta kërkojë biznesi i Korporatës.

2. Bordi i guvernatorëve miraton rregulla dhe rregullore, sipas të cilave, nëse nuk ka drejtor të shtetësisë së tij, një shtet anëtar mund të dërgojë një përfaqësues për të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në çdo mbledhje të bordit të drejtorëve kur shqyrtohet një çështje që prek veçanërisht atë shtet anëtar.

Neni 40

1. Çdo anëtar ka një votë për çdo aksion të pajtuar dhe paguar.

2. Për votimin në bordin e guvernatorëve, çdo guvernator ka të drejtën të hedhë atë pjesë proporcionale të votave të Bankës në Korporatë që është e barabartë me raportin e përfaqësuar nga numri i aksioneve në bankën e shtetit anëtar që ai përfaqëson, në lidhje me kapitalin e përgjithshëm të Bankës. Nëse një anëtar i bankës është edhe shtet anëtar i Korporatës, guvernatori që e përfaqëson atë (përveç pjesës proporcionale të votave të Bankës që përcaktohen si më sipër), ka të drejtë të hedhë votat që një shtet anëtar i tillë ka të drejtë në Korporatë.

3. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, të gjitha çështjet para bordit të guvernatorëve vendosen me shumicën e fuqisë votuese që përfaqësohet në mbledhje.

4. Pa cenuar paragrafin 1 të këtij neni, në votim në bordin e drejtorëve:

a) Një drejtor i emëruar ka të drejtë të hedhë votat që shteti anëtar që ai përfaqëson ka të drejtë në Korporatë. Përveç kësaj, drejtori ka të drejtë të hedhë atë pjesë proporcionale të votave të Bankës në Korporatë që është e barabartë me raportin e përfaqësuar në numrin e aksioneve në Bankë të shtetit anëtar që ai përfaqëson, në lidhje me kapitalin e përgjithshëm të Bankës;

b) Një drejtor i zgjedhur ka të drejtë të hedhë votat që shtetet anëtare të Bankës që ai përfaqëson kanë të drejtën në Korporatë. Përveç kësaj, ky drejtor ka të drejtë të hedhë atë pjesë proporcionale të votave të bankës në Korporatë që është e barabartë me raportin e përfaqësuar nga numri i plotë i aksioneve në bankë të shteteve anëtare që ai përfaqëson, në lidhje me të gjithë kapitalin e Bankës. Votat që ka të drejtë t'i hedhë një drejtor i zgjedhur nuk është e nevojshme të hidhen në bllok.

Neni 41

Presidenti

1. Presidenti i Bankës është automatikisht Presidenti i Korporatës.

2. Presidenti është drejtori i përgjithshëm i Korporatës dhe drejton punët e Korporatës nën drejtimin e bordit të drejtorëve. Presidenti është përgjegjës për organizatat, emërimin dhe largimin nga detyra të punonjësve dhe personelit në pajtim me rregullat dhe rregulloret e miratuara nga bordi i drejtorëve.

3. Presidenti është përfaqësuesi ligjor i Korporatës dhe ka kompetencën t'i aprovojë operacionet e Korporatës dhe lidhjen e kontratave për këtë brenda udhëzimeve të përgjithshme të bordit të drejtorëve.

4. Në emërimin e punonjësve dhe personelit në pajtim me paragrafin 2, Presidenti, në pajtim me rëndësinë e madhe për sigurimin e standardeve më të larta të efikasitetit dhe kompetencës teknike, i kushton rëndësi rekrutimit të personelit mbi një bazë sa më të gjerë gjeografike që të jetë e mundur.

5. Pa cenuar përgjithësimin e sa më sipër, presidenti mund të emërojë një menaxher në Korporatë, të cilit i ngarkohet biznesi i përditshëm i Korporatës. Presidenti mund t'i delegojë menaxherit çdo kompetencë të presidentit sipas kësaj Marrëveshjeje. Presidenti cakton pagën dhe kushtet e shërbimit të menaxherit dhe mund ta riemërojë atë.

Neni 42

Karakteri i brendshëm i Korporatës dhe ndalimi i aktivitetit politik

1. Korporata, drejtorët e saj, presidenti, menaxheri, punonjësit dhe personeli nuk ndërhyjnë në aktivitetet politike të asnjë shteti anëtar. Pa cenuar të drejtën e Korporatës për të marrë parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me një investim ose një kredi eksporti, Korporata, drejtorët e saj, presidenti, menaxheri, punonjësit dhe personeli nuk ndikohen në vendimet e tyre nga karakteri politik i anëtarit ose shteteve anëtare përkatëse.

2. Në përmbushje të detyrave të tyre, presidenti, menaxheri, punonjësit dhe personeli i Korporatës e përmbushin detyrën e tyre tërësisht kundrejt Korporatës dhe kundrejt asnjë autoriteti tjetër. Secili anëtar i Korporatës respekton karakterin ndërkombëtar të kësaj detyre dhe kufizohet në të gjitha përpjekjet për të ndikuar mbi ta në ushtrimin e detyrave të tyre.

Neni 43

Kanali i komunikimit dhe depozituesit

Përveç kur nga shtetet anëtare tregohen kanale të reja komunikimi dhe depozitues të rinj brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, kanali i komunikimit dhe depozituesi i caktuar nga çdo shtet anëtar për qëllimin e nenit 40 të neneve të Marrëveshjes themeluese të Bankës konsiderohet përkatësisht të jetë kanali i komunikimit në lidhje me çdo çështje që del nga kjo Marrëveshje dhe depozituesi për mbajtjen e aksioneve të Korporatës në monedhën e atij shteti anëtar, si dhe sendeve të tjera pasurore të Korporatës.

Neni 44

Deklarimet dhe raportet

1. Korporata u transmeton anëtarëve deklarime semestrale që tregojnë rezultatet e operacioneve.

2. Korporata mund të publikojë edhe ato raporte që ajo i konsideron të dëshirueshme për arritjen e qëllimit dhe funksioneve. Këto raporte u transmetohen anëtarëve.

KAPITULLI VI

TËRHEQJA DHE PEZULLIMI I ANËTARËVE, PEZULLIMI I PËRKOHSHËM DHE PËRFUNDIMI I OPERACIONEVE TË KORPORATËS

Neni 45

Tërheqja

1. Asnjë shtet anëtar nuk ka të drejtë të tërhiqet nga Korporata para skadimit të afatit prej pesë (5) vitesh që nga data e anëtarësimit.

2. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, çdo shtet anëtar mund të tërhiqet nga Korporata duke i paraqitur një njoftim me shkrim Korporatës.

3. Në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni, tërheqja e një shteti anëtar hyn në fuqi dhe anëtarësia e tij mbaron në datën e përcaktuar në njoftimin e tij, por në asnjë rast në më pak se gjashtë (6) muaj pas datës që është marrë njoftimi nga Korporata. Megjithatë, në çdo kohë para se tërheqja të hyjë në fuqi, shteti anëtar mund të njoftojë Korporatën me shkrim për anulimin e njoftimit mbi qëllimin për t'u tërhequr.

4. Një shtet anëtar që tërhiqet mbetet përgjegjës për të gjitha detyrimet e drejtpërdrejta dhe të mundshme kundrejt Korporatës ndaj të cilave ajo ishte përgjegjëse në datën kur tërheqja e saj hyn në fuqi. Shteti anëtar që tërhiqet, vazhdon gjithashtu t'u nënshtrohet atyre kushteve të Marrëveshjes që, sipas mendimit të Korporatës, ndikojnë investimet e Korporatës në territoret e atij shteti anëtar derisa të përfundohen masat e pranueshme për Korporatën në lidhje me këto investime ndërmjet Korporatës dhe shtetit anëtar. Kur tërheqja të hyjë në fuqi, shteti anëtar nuk merr asnjë përgjegjësi për detyrimet që rrjedhin nga operacionet e Korporatës që kryhen pas asaj date.

5. Çdo shtet anëtar që pushon së qeni anëtar i Organizatës, konsiderohet të ketë bërë njoftim për tërheqje nga anëtarësia e Korporatës sipas dispozitave të këtij neni. Data kur tërheqja hyn përfundimisht në fuqi përcaktohet nga bordi i guvernatorëve, në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 46 **Pezullimi i anëtarësisë**

1. Nëse një shtet anëtar nuk përmbush detyrimet e tij ndaj Korporatës, bordi i guvernatorëve mund ta pezullojë këtë shtet anëtar me një votë, që përfaqëson jo më pak se tre të katërtat e të gjithë fuqisë votuese të anëtarëve.

2. Shteti anëtar i pezulluar automatikisht pushon së qeni anëtar i Korporatës me mbarimin e afatit prej një viti nga data e pezullimit të tij, ku ky afat mund të zgjatet siç të konsiderohet e nevojshme nga bordi i guvernatorëve, përveç kur bordi i guvernatorëve, gjatë këtij afati, vendos me të njëjtën shumicë të nevojshme për pezullimin, të rikthejë shtetin anëtar në gjendjen e mëparshme.

3. Gjatë pezullimit, një shtet anëtar nuk ka të drejtë të ushtrojë asnjë të drejtë sipas kësaj Marrëveshjeje, por mbetet përgjegjës për të gjitha detyrimet e tij.

Neni 47 **Ndarja e llogarive me mbarimin e anëtarësisë**

1. Pas datës në të cilën një shtet pushon së qeni anëtar, ai mbetet përgjegjës për të gjitha detyrimet e tij të drejtpërdrejta ndaj Korporatës që janë shkaktuar deri në atë datë. Ai mbetet gjithashtu përgjegjës për detyrimet e paparashikuara të tij ndaj Korporatës, nëse një pjesë e operacioneve të kryera para se ai të pushonte së qeni anëtar mbeten të pashlyera, por ai nuk merr përsipër detyrime në lidhje me operacionet e kryera pas kësaj nga Korporata dhe nuk merr pjesë në të ardhurat ose shpenzimet e Korporatës.

2. Në momentin që një shtet pushon së qeni anëtar, Korporata merr masa për riblerjen e aksioneve të këtij shteti si një pjesë e ndarjes së llogarive me këtë shtet në pajtim me dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni. Për këtë qëllim, çmimi i riblerjes së aksioneve do të jetë vlera e bilancit të këtyre aksioneve në datën që shteti pushon së qeni anëtar.

3. Pagesa e riblerjes së aksioneve nga Korporata sipas këtij neni rregullohet nga kushtet e mëposhtme:

a) Çdo shumë që i detyrohet shtetit anëtar përkatës për aksionet e tij do të mbahet derisa ai shtet anëtar, banka e tij qendrore ose një prej agjencive të tij, instrumentet ose nënndarjet politike kanë detyrime të pashlyera ndaj Korporatës. Çdo shumë që i detyrohet një shteti anëtar të tillë, sipas zgjedhjes së Korporatës, mund të zbatohet për çdo detyrim të këtij shteti anëtar pas maturimit të tij.

b) Shuma neto, e barabartë me shtesën e çmimit të riblerjes për aksionet (në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni) mbi shumën e përgjithshme të detyrimeve të shtetit anëtar përkatës ndaj Korporatës, është e pagueshme brenda një afati që nuk i kalon pesë (5) vjet, siç mund të përcaktohet nga Korporata, pas transferimit të pronësisë së pjesës përkatëse nga shteti anëtar përkatës.

c) Pagesat bëhen në një monedhë lirisht të konvertueshme, dhe

d) Nëse humbjet rikuperohen nga Korporata nga operacionet e sigurimit dhe risigurimit që ishin të pashlyera të datën kur një shtet anëtar pushoi së qeni anëtar dhe shuma e këtyre humbjeve e kalon shumën e rezervës së parashikuar për humbjet në atë datë, shteti anëtar shlyen, me kërkesë, shumën me të cilën çmimi i riblerjes së aksioneve të tij do të ishte pakësuar nëse humbjet do të ishin marrë parasysh kur u përcaktua çmimi i riblerjes.

4. Nëse Korporata i pushon operacionet e saj në pajtim me nenin 49 të kësaj Marrëveshjeje brenda gjashtë (6) muajve nga data në të cilën një shtet anëtar pushon së qeni anëtar, të gjitha të drejtat e shtetit anëtar përkatës përcaktohen në pajtim me dispozitat e nenit 49 dhe 51. Ky shtet anëtar konsiderohet të jetë anëtar për qëllimet e këtyre neneve, por nuk ka të drejta vote.

Neni 48

Pezullimi i përkohshëm i operacioneve

1. Bordi i drejtorëve, kurdoherë që konsiderohet e arsyetuar, pezullon dhënien e shërbimeve të sigurimeve dhe risigurimeve për një afat të caktuar.

2. Në raste emergjence, bordi i drejtorëve mund të pezullojë të gjitha aktivitetet e Korporatës për një afat që nuk e kalon kohëzgjatjen e kësaj emergjence, me kusht që të merren masat e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Korporatës dhe të palëve të treta.

3. Vendimi për të pezulluar operacionet nuk ka efekt mbi detyrimet e anëtarëve sipas kësaj Marrëveshjeje ose për detyrimet e Korporatës kundrejt zotëruesve të policave ose palëve të treta.

Neni 49

Përfundimi i operacioneve

1. Korporata mund të përfundojë operacionet me anë të një rezolute të bordit të guvernatorëve të aprovuar me një votë prej dy të tretat e numrit të përgjithshëm të guvernatorëve që përfaqëson jo më pak se tre të katërtat e fuqisë së përgjithshme të votimit të anëtarëve. Pas këtij përfundimi, Korporata pushon menjëherë të gjitha aktivitetet, përveç atyre që kërkohen për realizimin, mbrojtjen dhe ruajtjen e sendeve të saj pasurore dhe përmbushjen e detyrimeve.

2. Deri në shlyerjen përfundimtare të këtyre detyrimeve dhe shpërndarjes së sendeve pasurore, Korporata mbetet në fuqi dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të Korporatës dhe anëtarëve të saj vazhdojnë të pacenuara.

Neni 50

Përgjegjësia e anëtarëve dhe pagesa e detyrimeve

1. Në rastin e përfundimit të operacioneve të Korporatës, përgjegjësia e shteteve anëtare për pajtimin e papaguar në kapitalin e Korporatës vazhdon derisa të jenë shlyer të gjitha detyrimet e kreditorëve dhe të zotëruesve të policave duke përfshirë detyrimet e paparashikuara.

2. Në rastin e përfundimit të operacioneve të Korporatës:

a) Borxhet që i përkasin fondit të aksionarëve paguhen nga sendet pasurore të fondit të aksionarëve. Nëse këto sende pasurore nuk mjaftojnë për t'i shlyer këto borxhe, ato paguhen nga pagesat që mbledhen nga Korporata nga pajtimet e pashlyera për t'u paguar.

b) Borxhet që i përkasin fondit të zotëruesve të policave paguhen së pari nga sendet pasurore të fondit të zotëruesve të policave. Pasi këto borxhe të jenë shlyer, këto pasohen nga shlyerja e detyrimeve të zotëruesve të policave. Nëse sendet pasurore të fondit të zotëruesve të policave nuk mjaftojnë për shlyerjen e këtyre detyrimeve, këto shlyhen nga fondi i aksionarëve. Nëse sendet pasurore të fondit të aksionarëve nuk janë të mjaftueshme për t'i shlyer këto detyrime, këto shlyen nga pagesat që mbledh Korporata nga pajtimet e pashlyera për t'u paguar, me kusht që kjo shlyerje të bëhet me kontribute të pakthyeshme.

c) Nëse sendet pasurore janë të pamjaftueshme për t'i shlyer borxhet ose paguar detyrimet e zotëruesve të policave, sendet pasurore të disponueshme shpërndahen ndërmjet kreditorëve dhe zotëruesve të policave proporcionalisht.

Neni 51

Shpërndarja e sendeve pasurore

1. Nëse pas shlyerjes së borxheve dhe detyrimeve të zotëruesve të policave mbeten sende pasurore në fondin e zotëruesve të policave, këto sende pasurore shpërndahen për qëllime bamirëse.

2. Nëse pas shlyerjes së borxheve dhe detyrimeve të zotëruesve të policave mbeten sende pasurore në fondin e aksionarëve, këto sende pasurore shpërndahen tek anëtarët e Korporatës në raport me kapitalin e paguar nga çdo anëtar. Kjo shpërndarje duhet të aprovohet nga bordi i guvernatorëve me një votë prej dy të tretat të të gjithë numrit të guvernatorëve, që përfaqëson jo më pak se tre të katërtat e fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve.

3. Çdo anëtar që merr sende pasurore të shpërndara sipas këtij neni, gëzon të njëjtat të drejta në lidhje me këto sende pasurore që kishte Korporata para shpërndarjes.

KAPITULLI VII IMUNITETET, PËRJASHTIMET DHE PRIVILEGJET

Neni 52

Imunitetet e Korporatës

Për t'i dhënë mundësi Korporatës të arrijë qëllimet e saj dhe përmbushë funksionet që i janë dhënë asaj, Korporatës, guvernatorëve të saj, zëvendësguvernatorëve, drejtorëve, presidentit, menaxherit, punonjësve, sendeve pasurore dhe komunikimeve në territorin e çdo shteti anëtar u jepen të gjitha imunitetet, përjashtimet dhe privilegjet përkatëse të parashikuara në nenet 53, 54, 55, 56, 57, 58 dhe 59 të neneve të marrëveshjes themeluese të Bankës.

Neni 53

Imuniteti i sendeve pasurore

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 54, pasuria dhe sendet pasurore të Korporatës kanë imunitet ndaj kërkimit, përftimit, konfiskimit, shpronësimit ose ndonjë formë tjetër sekuestrimi me masë ekzekutive ose legjislative.

2. Në masën që është e nevojshme për të përmbushur operacionet sipas kësaj Marrëveshjeje, të gjitha pasuritë dhe sendet pasurore të Korporatës janë të lira nga kufizimet, rregulloret, kontrollet dhe moratoriumet e çdo lloji, me kusht që pasuria dhe sendet pasurore të përftuara nga Korporata, si trashëgimtare ose zëvendësuese e një zotëruesi police, të jenë të lira nga kufizimet, rregulloret dhe kontrollet e huaja në fuqi, të zbatueshme për këmbimin në territoret e shtetit anëtar përkatës në masën që zotëruesit të policës, të cilin ka zëvendësuar Korporata, i është dhënë për një trajtim të tillë.

Neni 54

Ndjekja ligjore

Paditë e ndryshme nga ato brenda objektit të nenit 59 mund të ngrihen kundër Korporatës vetëm në një gjykatë me juridiksion kompetent në territoret e një shteti anëtar në të cilin Korporata ka një zyrë ose ka emëruar një agjent për qëllimin e marrjes së njoftimit të padisë. Asnjë padi e tillë nuk ngrihet kundër Korporatës: (i) nga anëtarët ose personat që veprojnë për ose rrjedhin detyrime nga, anëtarët, ose (ii) në lidhje me çështjet e personelit. Pasurisë dhe sendeve pasurore të Korporatës, kudo që të ndodhen dhe nga kushdo, u jepen të gjitha imunitetet e parashikuara në nenet 52 dhe 53 deri në dorëzimin e vendimit përfundimtar ose vendimit të arbitrazhit kundër Korporatës.

Neni 55

Zbatimi

Çdo shtet anëtar, në pajtim me sistemin e tij ligjor, merr menjëherë ato masa që janë të nevojshme për të bërë të zbatueshme në territorin e vet dispozitat që gjenden në këtë kapitull dhe informon Korporatën për veprimin që ka ndërmarrë për çështjen.

Neni 56

Heqja dorë nga imunitetet, përjashtimet dhe privilegjet

Korporata, sipas zgjedhjes së saj, mund të heqë dorë nga çdo privilegj, imunitet dhe përjashtim që i jepet sipas këtij kapitulli në çdo rast, në atë mënyrë dhe me ato kushte që ajo mund të vendosë se është më e përshtatshme për interesat e saj të larta.

KAPITULLI VIII AMENDIMET, INTERPRETIMI, ARBITRAZHI

Neni 57 Amendimet

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me një rezolutë të bordit të guvernatorëve të aprovuar me një votë prej dy të tretat të numrit të përgjithshëm të guvernatorëve, që përfaqësojnë jo më pak se tre të katërtat e gjithë fuqisë votuese të anëtarëve.

2. Pavarësisht dispozitave të paragrafit (1) të këtij neni, marrëveshja unanime e bordit të guvernatorëve kërkohet për aprovimin e çdo ndryshimi që modifikon:

- a) të drejtën për t'u tërhequr nga Korporata;
- b) kufizimet mbi përgjegjësinë e parashikuar në paragrafët (2) dhe (3) të nenit 12; dhe
- c) të drejtat që i përkasin blerjes së kapitalit të parashikuar në paragrafin (5) të nenit 9.

3. Çdo propozim për ta ndryshuar këtë Marrëveshje, që vjen nga një anëtar ose nga bordi i drejtorëve, i komunikohet kryetarit të bordit të guvernatorëve që e sjell propozimin në bordin e guvernatorëve. Kur miratohet një ndryshim, Korporata e vërteton këtë në një komunikim zyrtar drejtuar të gjithë anëtarëve. Ndryshimet hyjnë në fuqi për të gjithë anëtarët tre (3) muaj pas datës së komunikimit zyrtar, përveç kur bordi i guvernatorëve specifikon një afat tjetër.

4. Asnjë ndryshim që mund të ndikojë në respektimin e Sheriahut nga Korporata, nuk mund të bëhet.

Neni 58 Gjuhët, interpretimi dhe zbatimi

1. Gjuha zyrtare e Korporatës është gjuha arabe. Përveç kësaj, gjuhët angleze dhe frënge janë gjuhë pune. Teksti në arabisht i Marrëveshjes konsiderohet si teksti autentik për interpretimin dhe zbatimin.

2. Çdo çështje e interpretimit ose zbatimit të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje që dalin ndërmjet një anëtari dhe Korporatës ose ndërmjet dy ose më shumë anëtarëve të Korporatës, i paraqiten bordit të drejtorëve për vendim. Nëse nuk ka drejtor të shtetësisë së shtetit anëtar përkatës, zbatohet paragrafi 2 i nenit 39.

3. Çdo anëtar mund të kërkojë, brenda gjashtë (6) muajve nga data e vendimit sipas paragrafit 2 të këtij neni, që çështja t'i referohet bordit të guvernatorëve, vendimi i të cilit është përfundimtar. Në pritje të vendimit të bordit të guvernatorëve, Korporata, në masën që e konsideron të nevojshme, vepron mbi bazën e vendimit të bordit të drejtorëve.

Neni 59 Arbitrazhi

1. Nëse lind një mosmarrëveshje ndërmjet Korporatës dhe një shteti që ka pushuar së qeni anëtar ose ndërmjet Korporatës dhe një anëtari, pas miratimit të një rezolute për të përfunduar operacionet e Korporatës ose ndërmjet Korporatës dhe një shteti anëtar në lidhje me pretendimet e Korporatës që vepron si zëvendësuese e një zotëruesi police, ose ndërmjet Korporatës dhe një anëtari për një çështje tjetër, të ndryshme nga çështjet e mbuluara nga paragrafi 2 i nenit 58, kjo mosmarrëveshje zgjidhet me pajtim. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje me pajtim, kjo mosmarrëveshje i paraqitet për arbitrazh një gjykatë prej tre (3) arbitrash. Një prej arbitrave emërohet nga Korporata, një tjetër nga pala e interesuar, dhe arbitri i tretë emërohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës. Një votë shumice e arbitrave është e mjaftueshme për të arritur një vendim që është përfundimtar dhe detyrues për palët. Arbitri i tretë ka kompetencë të zgjidhë të gjitha çështjet procedurale, në rastin kur palët nuk bien dakord në lidhje me to.

2. Çdo mosmarrëveshje që lind nga një kontratë sigurimi ose risigurimi nga palët përkatëse i paraqitet arbitrazhit për vendim përfundimtar në pajtim me ato rregulla që parashikohet ose referohet në kontrata të veçanta.

Neni 60
Aprovimi i menduar i dhënë

Kurdoherë që kërkohet aprovimi i një anëtari, para se të ndërmerret një veprim nga Korporata, aprovimi konsiderohet i dhënë, përveç kur anëtari paraqet kundërshtim brenda një afati të arsyeshëm që mund të përcaktohet nga Korporata në njoftimin e anëtarit për veprimin e propozuar.

KAPITULLI IX
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 61
Nënshkrimi dhe depozitimi

1. Originali i kësaj Marrëveshjeje, në një kopje të vetme në gjuhët arabe, angleze dhe frënge, mbetet e hapur për nënshkrim deri më 15 Shaban 1413H/6 shkurt 1993 në selinë e Bankës nga Banka dhe qeveritë e shteteve të renditura në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje. Ky dokument depozitohet në zyrat kryesore të Korporatës në momentin e themelimit të saj.

2. Nëpërmjet ratifikimit ose pranimit të kësaj Marrëveshjeje, shteti përkatës anëtar konsiderohet të ketë autorizuar Korporatën, kurdoherë, të ofrojë në territoret e këtij shteti anëtar shërbime sigurimi dhe risigurimi në pajtim me këto dispozita.

Neni 62
Ratifikimi ose pranimi dhe efektet

1. Kjo Marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit ose pranimit nga Banka dhe shtetet palë në të. Instrumentet e ratifikimit ose pranimit depozitohen në Bankë, e cila njofton rregullisht palët e tjera për çdo depozitim dhe datën e tyre.

2. Nëpërmjet ratifikimit ose pranimit të kësaj Marrëveshjeje shteti anëtar përkatës konsiderohet të ketë autorizuar Korporatën që të japë gjithmonë në territoret e atij shteti anëtar shërbime sigurimi dhe risigurimi në pajtim me këto dispozita.

Neni 63
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi kur të jenë depozituar instrumentet e ratifikimit dhe pranimit të shteteve anëtare, pajtimet e të cilëve në tërësi përbëjnë jo më pak se njëzet e pesë milionë dinarë islamikë (ID 25 000 000).

Neni 64
Fillimi i operacioneve

1. Në mbledhjen e tij inauguruese, bordi i guvernatorëve merr të gjitha masat për përcaktimin e datës në të cilën Korporata fillon operacionet e saj.

2. Korporata njofton anëtarët e saj për datën e fillimit të operacioneve të saj.

Bërë në Tripoli, Jamahiria Arabe Libiane Popullore e Madhe Socialiste, më 15 Shaban 1412H, që përputhet me 19 shkurt 1992.

LIGJ
Nr.10 151, datë 28.9.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES FINANCIARE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMISIONIT TË
KOMUNITETEVE EUROPIANE PËR PROGRAMIN NDËRKUFITAR SHQIPËRI-MALI I
ZI, PËR VITIN 2008, TË KOMPONENTIT TË DYTË TË INSTRUMENTIT TË
PARAADERIMIT, IPA - BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR PËR SHQIPËRINË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja financiare ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Europiane për programin ndërkufitar Shqipëri - Mali i Zi, për vitin 2008, të komponentit të dytë të Instrumentit të Paraaderimit, IPA - bashkëpunimi ndërkufitar për Shqipërinë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.6286, datë 7.10.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE FINANCIMI

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE EUROPIANE MBI PROGRAMIN NDËRKUFITAR
SHQIPËRI-MALI I ZI NËNKOMPONENTI II-BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR SHQIPËRI
PËR VITIN 2008**

(datë:Menaxhim i centralizuar)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtej e tutje referuar bashkërisht si “palët” ose individualisht si “vendi përfitues”, në rastin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose “Komisioni”, në rastin e Komisionit të Komuniteteve Europiane,

duke pasur parasysh se:

a) në 1 gusht 2006, Këshilli i Bashkimit Europian vendosi me anë të rregullores (EC) nr.1085/2006 krijimin e një instrumenti të asistencës për paraaderimin (këtej e tutje: “Rregullorja kuadër IPA”). Me efekt nga 1 janari 2007, ky instrument përfaqëson bazën e vetme ligjore për dhënien e asistencës financiare për vendet candidate (aktualisht Kroacia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia) dhe vendet candidate potenciale (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Serbia, duke përfshirë Kosovën sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara), në përpjekjet e tyre për të forcuar reformat politike, ekonomike dhe institucionale me perspektivën për t'u bërë një ditë anëtare të Bashkimit Europian;

b) në 12 qershor 2007 Komisioni vendosi me anë të rregullores (EC) nr.718/2007 zbatimin e rregullores kuadër IPA, e cila detajon rregullat e aplikueshme të menaxhimit dhe të kontrollit (këtej e tutje: “Rregullorja e zbatimit IPA”);

c) asistenca komunitare nën instrumentin e asistencës për paraaderimin duhet të vazhdojë të mbështesë vendet përfituese në përpjekjet e tyre për të forcuar institucionet demokratike dhe shtetin e së drejtës, të reformojë administratën publike, të ndërmarrë reforma ekonomike, të respektojë të drejtat e njeriut dhe ato të minoriteteve, të promovojë barazinë gjinore, të mbështesë zhvillimin e shoqërisë civile dhe të çojë përpara bashkëpunimin rajonal, si dhe ripajtimin dhe rindërtimin, dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe reduktimin e varfërisë;

Për vendet potenciale kandidate, asistenca komunitare mund të përfshijë përafrimin me *acquis communautaire*, si dhe mbështetjen për projekte në investime, që kanë për qëllim në veçanti ndërtimin e kapaciteteve menaxhuese në fushat e zhvillimit rajonal, të burimeve njerëzore dhe atë rural.

d) palët kanë nënshkruar në 18 tetor 2007 një marrëveshje kuadër, që përcakton rregullat e përgjithshme për bashkëpunim dhe zbatimin e asistencës komunitare nën instrumentin e ndihmës së paraaderimit;

e) programi ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi për vitet 2007-2009 u aprovua me vendimin C(2007)6342 të datës 17 dhjetor 2007;

f) në datë 25 korrik 2008 Komisioni aprovoi propozimin e financimit për vitin 2008 të programit ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi (këtej e tutje: “programi”). Ky program do të zbatohet nga Komisioni në mënyrë të centralizuar;

g) për implementimin e këtij programi është e nevojshme që palët të nënshkruajnë një marrëveshje financimi për të përcaktuar kushtet për dhënien e asistencës komunitare, rregullat dhe procedurat që lidhen me disbursimin e kësaj asistence dhe kushteve, sipas të cilave do të menaxhohet kjo asistencë;

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

1. Programi

Komisioni do të kontribuojë me anë të një granti për financimin e programit në vijim, i cili është përcaktuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

Numri i programit: 2008/019-946 (CRIS)

Titulli: Programi ndërkufitar Shqipëri-Mali i Zi nën komponentin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA për vitin 2008.

2. Zbatimi i programit

1. Programi do të zbatohet nga Komisioni në një mënyrë të centralizuar, sipas nenit 53 a të rregullores së Këshillit (EC, Euratom) nr.1605/2002 mbi rregulloren financiare të aplikueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve, të ndryshuar sipas rregullores (EC, Euratom)1995/2006 të datës 13 dhjetor 2006 (këtej e tutje: “Rregullorja financiare”).

2. Programi do të zbatohet në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes kuadër mbi rregullat për bashkëpunimin që lidhen me asistencën financiare të BE-së për Shqipërinë dhe zbatimin e asistencës në kuadër të instrumentit të paraaderimit (IPA) të arritur ndërmjet palëve në 18 tetor 2007 (këtej e tutje: “Marrëveshja kuadër”), e cila ndodhet në aneksin B të kësaj Marrëveshjeje.

3. Strukturat dhe autoritetet përgjegjëse

1. Përfituesi do të caktojë një koordinator kombëtar IPA në përputhje me Marrëveshjen kuadër, i cili do të veprojë si përfaqësuesi i përfituesit përballë Komisionit. Ai/ajo duhet të sigurojë që ekziston një lidhje e fortë ndërmjet Komisionit dhe përfituesit si për procesin e përgjithshëm të aderimit, ashtu edhe për asistencën e BE-së për paraaderimin nën instrumentin IPA.

2. Koordinatori kombëtar IPA do të jetë gjithashtu përgjegjës për koordinimin e pjesëmarrjes së vendit përfitues në programet përkatëse ndërkufitare, si dhe në programet transnacionale, ndërrajonale ose në programet që përfshijnë vende që lagen nga dete, nën instrumente të tjera të Komunitetit.

3. Vendi përfitues duhet të ngrejë një strukturë operuese për pjesën e programit në territorin e vet. Funksionet dhe përgjegjësitë e saj janë të përcaktuara në programin ndërkufitar, me përjashtim të tenderimit, kontraktimit dhe pagesave, të cilat janë përgjegjësi e Komisionit.

4. Struktura operuese duhet të bashkëpunojë ngushtë gjatë zbatimit të këtij programi me strukturën (at) operuese të Malit të Zi.

5. Strukturat operuese të vendeve pjesëmarrëse duhet të ngrenë një sekretariat të përbashkët teknik për të asistuar strukturat operuese dhe komitetin e përbashkët monitorues si referuar në nenin 142 të rregullores së implementimit IPA në përmbushjen e detyrave të tyre respektive.

Sekretariati i përbashkët teknik mund të ketë antenë të ngritur në secilin vend pjesëmarrës.

4. Financimi

Financimi për implementimin e kësaj Marrëveshjeje do të jetë si më poshtë:

a) Kontributi i Komunitetit për vitin 2008 është përcaktuar në një maksimum prej 750,000 €, për pjesën e programit që ka të bëjë me Shqipërinë si detajohet në shtojcën A1 të shtojcës A të kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, pagesa e kontributit të Komunitetit nga Komisioni do të bëhet brenda limiteve të fondeve në dispozicion.

b) Kostoja e strukturave dhe autoriteteve të ngritura nga vendi përfitues për zbatimin e këtij programi do të mbulohet nga përfituesi, me përjashtim të kostove referuar në nenin 94 (1)(f) të rregullores së zbatimit IPA, si detajuar në shtojcën A.

5. Afati përfundimtar për nënshkrimin e kontratave

1. Kontratat dhe marrëveshjet individuale, të cilat zbatojnë këtë Marrëveshje, do të nënshkruhen jo më vonë se dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, ky afat kontraktimi mund të zgjatet përpara datës së përfundimit të tij për një periudhë maksimale prej tre vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

3. Çdo financim, për të cilin nuk është nënshkruar një kontratë përpara afatit për përfundimin e tij, do të anulohet.

6. Afati për ekzekutimin e kontratave

1. Kontratat duhet të zbatohen maksimumi brenda dy vjetësh që nga data e nënshkrimit të tyre.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati përfundimtar i zbatimit të kontratave mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të tyre.

7. Afati i disbursimit

1. Disbursimi i fondeve duhet të bëhet jo më vonë se një vit nga data përfundimtare e ekzekutimit të kontratave.

2. Në raste të justifikuara siç duhet, afati për disbursimin e fondeve mund të shtyhet përpara datës së përfundimit të saj (kontratës).

8. Përpunimi i fitimeve

1. Fitimi, në kuadër të IPA-s, përfshin të ardhurat e fituara nga një aktivitet gjatë periudhës së bashkëfinancimit IPA, duke filluar nga shitjet, qiratë, shërbimet/taksat ose të ardhura të tjera ekuivalente, me përjashtim të:

a) fitimeve të nxjerra gjatë jetës ekonomike të investimeve të bashkëfinancuara në raste të investimeve në firma;

b) fitimeve të nxjerra brenda kuadrit të një mase financiare inxhinierie, duke përfshirë kapitalin e një sipërmarrjeje dhe fondet hua, fondet e garancisë, kredive;

c) aty ku është e aplikueshme, kontributeve nga sektori privat për bashkëfinancimin e aktiviteteve, të cilat do të paraqiten së bashku me kontributin publik në tabelat financiare të programit.

2. Fitimet, si përkufizuar në paragrafin 1 më lart, paraqesin të ardhura të cilat duhet të zbriten nga shuma e shpenzimeve të lejueshme për aktivitetin në fjalë. Jo më vonë se mbyllja e programit këto fatura duhet të zbriten nga shpenzimet e lejueshme relevante për aktivitetin në shumën e tyre të plotë ose proporcionalisht, në varësi të asaj nëse burojnë plotësisht ose pjesërisht nga aktiviteti i bashkëfinancuar.

9. Shpenzimet e lejueshme

1. Shpenzimi në kuadër të këtij programi në shtojcën A do të jetë i lejueshëm për kontributin e Komunitetit, nëse ai është kryer aktualisht pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

2. Shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të lejueshme për kontributin e Komunitetit në kuadër të programit në aneksin A:

- a) taksat, duke përfshirë taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH);
- b) detyrimet doganore dhe të importit, ose çdo detyrim tjetër;
- c) blerjet, dhëniet me qira ose me kredi të truallit dhe godinave ekzistuese;
- d) gjobat, ndëshkimet financiare dhe shpenzimet për proceset gjyqësore;
- e) kostot operacionale;
- f) pajisje të dorës së dytë;
- g) detyrime bankare, kostot për vënie garancie dhe detyrime të ngjashme;
- h) kostot për shkëmbime, detyrime dhe humbje nga këmbimi i monedhave të lidhura me ndonjë komponent specifik të llogarive bankare në euro, si dhe shpenzime të tjera financiare;
- i) kontribute në natyrë
- j) interesa mbi borxhe.

3. Me shmangie nga paragrafi 2 më lart, shpenzimet e mëposhtme do të jenë të lejueshme:

- a) taksat mbi vlerën e shtuar, nëse përmbushen kushtet e mëposhtme:
 - i) nuk janë të rikthyeshme në asnjë lloj mënyre,
 - ii) është përcaktuar që ato janë kryer nga përfituesi përfundimtar, dhe
 - iii) janë të identifikuar qartë në projektpropozim.
- b) detyrimet për transaksione financiare transnacionale;
- c) në rast se zbatimi i një aksioni kërkon që të hapet një ose më shumë llogari të veçanta, detyrimet bankare për hapjen dhe administrimin e llogarive;
- d) kostot për konsulencë ligjore, kostot noteriale, kostot për ekspertë teknikë ose financiarë, dhe kostot financiare dhe të auditimit, nëse ato janë të lidhura direkt me aksionin e bashkëfinancuar dhe janë të nevojshme për përgatitjen ose zbatimin e tij;
- e) kostot e garancisë të siguruara nga një bankë ose institucione të tjera financiare, në rastet kur një gjë e tillë kërkohet nga legjislacioni kombëtar ose ai i Komunitetit;
- f) shpenzime të përgjithshme të vërtetuara që janë të bazuara në kosto reale të kërkuara gjatë zbatimit të aktivitetit respektiv. Normat bazë të llogaritura mbi bazën e kostove mesatare nuk mund të kalojnë 25% të atyre kostove direkte të një aktiviteti, i cili mund të ndikojë nivelin e shpenzimeve të përgjithshme. Përllogaritja duhet të dokumentohet plotësisht dhe të rishikohet periodikisht;
- g) blerja e truallit me një shumë prej deri në 10% të shpenzimeve të lejueshme të aktivitetit respektiv.

4. Përveç asistencës teknike për programin referuar nenit 94 të rregullores së zbatimit IPA, shpenzimet e mëposhtme të paguara nga autoritete publike gjatë përgatitjes dhe zbatimit të një aktiviteti do të jenë të lejueshme:

- a) kostot e shërbimeve të specializuara të ofruara nga një autoritet publik që është i ndryshëm nga përfituesi final gjatë përgatitjes ose zbatimit të një aktiviteti.
- b) kostot për sigurimin e shërbimeve që lidhen me përgatitjen dhe implementimin e një aktiviteti të ofruar nga një autoritet publik, i cili është vetë përfituesi final që kryen një aktivitet për llogari të tij pa kërkuar ofrues shërbimesh të tjerë nëse ato janë kosto shtesë dhe lidhen ose me shpenzime të paguara aktualisht ose direkt për aktivitetin e bashkëfinancuar.

Autoritetet publike respektive duhet ose t'ua dërgojnë kostot e referuara në pikën "a" të këtij paragrafi përfituesve përfundimtarë ose t'i certifikojnë këto kosto në bazë të dokumenteve që dëshmojnë se kanë të njëjtën vlerë, të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga ai autoritet për atë aktivitet.

Kostot e referuara në pikën "b" të këtij paragrafi duhet të jenë të certifikuara me anë të dokumenteve të cilat bëjnë të mundur identifikimin e kostove reale të paguara nga autoriteti publik respektiv për atë aksion.

5. Duke respektuar rregullat në paragrafët 1 dhe 4, rregulla të mëtejshme mbi shpenzimet e lejueshme mund të përcaktohen në programin ndërkufitar në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje.

10. Ruajtja e dokumenteve

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me programin në shtojcën A, duhet të ruhen të paktën për pesë vjet që nga data në të cilën Parlamenti European mbyll vitin buxhetor të cilit i përket dokumenti.

2. Në rast se programi në aneksin A nuk është mbyllur përfundimisht brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1 më lart, dokumentet e lidhura me të duhet të mbahen deri në fund të vitit i cili pason vitin në të cilin programi në aneksin A është mbyllur.

11. Plani për decentralizimin pa kontrolle ex-ante

1. Vendi përfitues duhet të përcaktojë një plan të detajuar me etapa indikative dhe limite kohore për të arritur decentralizimin me kontrolle *ex ante* nga Komisioni. Përveç kësaj, vendi përfitues duhet të hartojë një plan indikativ për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* nga Komisioni.

2. Komisioni duhet të monitorojë zbatimin e planeve të përmendura në paragrafin 1 dhe të marrë parasysh rezultatet e arritura nga vendi përfitues në këtë kontekst, në veçanti në sigurimin e asistencës. Plani për të arritur decentralizimin pa kontrolle *ex-ante* mund t'i referohet heqjes dorë gradualisht nga tipet e ndryshme të kontrolleve *ex-ante*.

3. Vendi përfitues duhet të mbajë të informuar rregullisht Komisionin mbi progresin e arritur në zbatimin e këtij plani.

12. Interpretimi

1. Në rastet ku një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, termat e kësaj dispozite duhet të mbajnë të njëjtin kuptim me termat e dispozitave të rregullores kuadër IPA dhe rregullores së zbatimit IPA.

2. Në rastet ku një dispozitë konkrete e kësaj Marrëveshjeje shprehet ndryshe, referencat e kësaj Marrëveshjeje do të jenë referencat e kësaj Marrëveshjeje, të ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

3. Çdo referencë ndaj rregulloreve të Këshillit apo Komisionit janë bërë ndaj versionit të tyre siç është treguar. Nëse kërkohet, modifikimet e këtyre rregulloreve duhet të zhvendosen në këtë Marrëveshjeje me anë të ndryshimeve.

4. Titujt në këtë Marrëveshje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë interpretimin e saj.

13. Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet e paqëllimshme

1. Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme ose kjo Marrëveshjeje përmban boshllëqe të paqëllimta, kjo nuk do të ndikojë vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët do të zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme, e cila është shumë e ngjashme me qëllimin dhe objektivin e dispozitës së pavlefshme.

2. Palët do të mbushin çdo boshllëk të paqëllimtë nëpërmjet një dispozite e cila i përshtatet sa më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me rregulloren kuadër IPA dhe rregulloren e zbatimit IPA.

14. Rishikimi dhe amendimi

1. Zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë subjekt i rishikimeve periodike në kohë të rëna dakord nëpërmjet palëve.

2. Çdo ndryshim për të cilin është rënë dakord ndërmjet palëve do të jetë me shkrim dhe do të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje. Ndryshime të tilla do të hyjnë në fuqi pasi vendosen ndërmjet palëve.

15. Përfundimi

1. Duke respektuar paragrafin 2, kjo Marrëveshjeje do të përfundojë tetë vjet pas hyrjes në fuqi të saj. Ky përfundim nuk do të përjashtojë mundësinë që Komisioni të bëjë korrigjime financiare, në përputhje me nenin 56 të rregullores së zbatimit IPA.

2. Kjo Marrëveshjeje mund të përfundojë nga secila palë duke informuar me shkrim palën tjetër. Ky përfundim do të japë efekt gjashtë muaj kalendarikë që nga data e njoftimit me shkrim.

16. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Mosmarrëveshjet e dala nga interpretimi, përdorimi dhe zbatimi i kësaj Marrëveshjeje, në secilën prej dhe të gjitha nivelet e pjesëmarrjes, do të rregullohen miqësisht nëpërmjet konsultimit mes palëve.

2. Në mungesë të zgjidhjeve miqësore, secila palë mund ta çojë çështjen për gjykim në përputhje me rregullat fakultative të gjykimit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, gjykimet që lidhen me organizatat ndërkombëtare dhe shtetet, në fuqi datën e kësaj Marrëveshjeje.

3. Gjuha që do të përdoret në procedurat e gjykimit do të jetë anglishtja. Autoriteti i caktuar do të jetë sekretari i përgjithshëm i Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, pas një kërkesë me shkrim të dërguar nga cilado nga palët. Vendimi i Gjykatës do të jetë i detyrueshëm për të gjitha palët dhe nuk do të ketë proces apelles.

17. Njoftime

1. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje do të bëhet në formë të shkruar dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim duhet të firmoset dhe duhet të dërgohet si një dokument zyrtar ose me faks.

2. Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komunitetin:

Z. Helmuth Lohan

Shef i delegacionit

Delegacioni i Komisionit European në Shqipëri

Rruga e Durrësit 127-1

Laparakë – Tiranë

Fax: + 355 4230752.

Për vendin përfitues:

Znj. Majlinda Bregu

Ministër i Integrimit European

Rruga: "Papa Gjon Pali II", nr.3

P.O.Box 8302

Tiranë, Shqipëri

Fax: + 355 4256267

18. Numri i origjinaleve

Marrëveshja e financimit është hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.

19. Shtojcat

Shtojcat A, B dhe C do të përbëjnë një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

20. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e nënshkrimit të saj. Në rast se palët nënshkruajnë në ditë të ndryshme, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga pala e dytë.

Firmosur për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë
në datë.....

Nga.....

Znj. Majlinda Bregu

Ministër i Integrimit European

Firmosur, për dhe në emër të komisionit, në Tiranë në datë 13.2.2009

Nga.....

Z. Helmuth Lohan

Shef i Delegacionit të Komisionit European

SHTOJCA A
PROGRAMI NDËRKUFITAR SHQIPËRI-MALI I ZI NË KOMPONENTIN
BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR IPA PËR VITIN 2008

Shtojca A1: Propozimi i financimit për vitin 2008 për programin ndërkufitar Shqipëri – Mali i Zi, aprovuar me vendimin e Komisionit C(2008)3825

Shtojca A2: Programi ndërkufitar Shqipëri – Mali i Zi, 2007-2009, aprovuar me vendimin e Komisionit C(2007)6342

SHTOJCA B
MARRËVESHJA KUADËR NDËRMJET KOMISIONIT TË KOMUNITETEVE
EUROPIANE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,
DATË 18 TETOR 2007

SHTOJCA C RAPORTIMI

1. Strukturat operuese të vendeve përfituese në një program ndërkufitar duhet t'i dërgojnë Komisionit dhe koordinatorëve kombëtarë respektivë IPA një raport vjetor dhe një raport final mbi zbatimin e programit ndërkufitar pas kontrollit të tyre nga komiteti i përbashkët i monitorimit.

Raporti vjetor duhet të dërgohet çdo vit brenda datës 30 qershor, raporti i parë në vitin e dytë që pason adaptimin e programit ndërkufitar.

Raporti final duhet të dërgohet jo më vonë se 6 muaj pas mbylljes së këtij programi.

2. Raportet e referuara në paragrafin 1 duhet të përmbajnë informacionin e mëposhtëm:

a) progresin e bërë gjatë zbatimit të programit ndërkufitar dhe prioritetet në raport me qëllimet specifike, të verifikueshme, me një përcaktim sasior të sasisë, kurdo dhe kudo që kjo të jetë e mundur duke përdorur indikatorët në nenin 94 (1) (d) të rregullores së zbatimit IPA në nivel të akteve prioritare;

b) hapat e ndërmarra nga strukturat operuese për të siguruar cilësinë dhe efektivitetin e zbatimit, në veçanti:

- masat monitoruese dhe vlerësuese, duke përfshirë masat për mbledhjen e të dhënave;

- një përmbledhje të problemeve të rëndësishme të hasura në zbatimin e këtij programi dhe çdo mase të marrë;

- përdorimin e asistencës teknike;

- c) masat e marra për të siguruar informimin dhe publicitetin mbi këtë program.

Aty ku është e përshtatshme, informacioni i referuar në pikat "a" deri në "c" të këtij paragrafi mund të jepen në formë të përmbledhur.

Nuk është e nevojshme që informacioni i referuar në pikën "b" të përfshihet nëse nuk ka pasur një ndryshim të rëndësishëm që nga raporti i mëparshëm.

Aneksi B

Marrëveshja kuadër midis Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave më datë 3.10.2007, me vendimin nr.642 dhe është firmosur më datë 18.10.2007 nga Ministri i Integritetit dhe Kryetari i Delegacionit të Komisionit të Komuniteteve Europiane në Tiranë. Kopja origjinale e marrëveshjes i është dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në datë 24.10.2007 me shkresën me nr. Protokolli 1710 dhe është ratifikuar nga Parlamenti më datë 10.12.2007 me ligjin nr.9840.

VENDIM
Nr.3, datë 16.9.2009

PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT

Në mbështetje të neneve 19 dhe 21 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Përbërja e Komisioneve të Përhershme të Kuvendit dhe e kryesive të tyre është si më poshtë:

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut:

- | | |
|---------------------|----------|
| 1. Ilir Rusmali | Kryetar |
| 2. Eduard Halimi | Sekretar |
| 3. Viktor Gumi | Anëtar |
| 4. Arenca Trashani | “ |
| 5. Dashnor Sula | “ |
| 6. Paulina Hoti | “ |
| 7. Gent Strazimiri | “ |
| 8. Astrit Bushati | “ |
| 9. Enkelejd Alibeaj | “ |
| 10. Ylli Lame | “ |
| 11. Nasip Naço | “ |

Komisioni për Ekonominë dhe Financat:

- | | |
|---------------------|----------|
| 1. Edmond Spaho | Kryetar |
| 2. Igli Cara | Sekretar |
| 3. Florion Mima | Anëtar |
| 4. Sybi Hida | “ |
| 5. Selami Xhepa | “ |
| 6. Sherefedin Shehu | “ |
| 7. Ledina Aliolli | “ |
| 8. Albana Vokshi | “ |
| 9. Gjokë Uldedaj | Anëtar |
| 10. Lefter Koka | “ |

Komisioni për Sigurinë Kombëtare:

- | | |
|--------------------|----------|
| 1. Leonard Demi | Kryetar |
| 2. Luan Skuqi | Sekretar |
| 3. Fatos Hoxha | Anëtar |
| 4. Paulin Sterkaj | “ |
| 5. Astrit Patozi | “ |
| 6. Lefter Maliqi | “ |
| 7. Vasillaq Ngresi | “ |

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin:

- | | |
|-------------------|----------|
| 1. Jemin Gjana | Kryetar |
| 2. Osman Metalla | Sekretar |
| 3. Ardian Kollozi | Anëtar |
| 4. Bedri Hoxha | “ |
| 5. Ardian Turku | “ |

- | | |
|--------------------|---|
| 6. Besnik Dusha | “ |
| 7. Gëzim Dibra | “ |
| 8. Ilir Bano | “ |
| 9. Dashamir Tahiri | “ |

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik:

- | | |
|-------------------|-----------------|
| 1. Mark Marku | Zëvendëskryetar |
| 2. Ismail Hoxha | Sekretar |
| 3. Mesila Doda | Anëtar |
| 4. Adriana Gjonaj | “ |
| 5. Rajmonda Bulku | “ |
| 6. Kreshnik Çipi | “ |
| 7. Edi Paloka | “ |
| 8. Gjergji Papa | “ |

Komisioni për Integrimin Europian:

- | | |
|---------------------|-----------------|
| 1. Aldo Bumçi | Zëvendëskryetar |
| 2. Fatbardh Kadilli | Sekretar |
| 3. Gerti Bogdani | Anëtar |
| 4. Rrahim Çota | “ |

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë:

- | | |
|------------------|-----------------|
| 1. Tritan Shehu | Zëvendëskryetar |
| 2. Rajmond Hoxha | Sekretar |
| 3. Flamur Noka | Anëtar |
| 4. Mehmet Xheka | “ |
| 5. Ndue Paluca | “ |

Komisioni për Politikën e Jashtme:

- | | |
|-------------------|----------|
| 1. Fatos Beja | Kryetar |
| 2. Luçiano Boçi | Sekretar |
| 3. Lajla Pernaska | Anëtar |
| 4. Gazmend Oketa | “ |
| 5. Vangjel Dule | “ |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.4, datë 16.9.2009

**PËR ZGJEDHJEN E ZËVENDËSKRYETARËVE, BYROSË
DHE PËRBËRJEN E SEKRETARIATEVE TË KUVENDIT**

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 10 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Kuvendi i Shqipërisë do të ketë tre zëvendëskryetarë.
II. Zgjidhen në detyrën e zëvendëskryetarëve të Kuvendit deputetët Ardian Turku dhe Nasip Naço.

III. Zgjidhen sekretariatet e Kuvendit si më poshtë:

Sekretariati për Buxhetin e Kuvendit:

- | | |
|---------------------|----------|
| 1. Florion Mima | Sekretar |
| 2. Sherefedin Shehu | Anëtar |
| 3. Jemin Gjana | “ |
| 4. _____ | Sekretar |
| 5. _____ | Anëtar |

Sekretariati për Procedurat dhe Votimet:

- | | |
|--------------------|----------|
| 1. Viktor Gumi | Sekretar |
| 2. Arenca Trashani | Anëtar |
| 3. _____ | “ |

Sekretariati për Statusin e Deputetit:

- | | |
|--------------------|----------|
| 1. Gent Strazimiri | Sekretar |
| 2. Paulina Hoti | Anëtar |
| 3. _____ | “ |

Sekretariati për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet Parlamentare:

- | | |
|-------------------|----------|
| 1. Mark Marku | Sekretar |
| 2. Ledina Aliolli | Anëtar |
| 3. _____ | “ |

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë:

- | | |
|------------------|----------|
| 1. Leonard Demi | Sekretar |
| 2. Rajmond Hoxha | Anëtar |
| 3. _____ | “ |

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 16.10.2009
Doli nga shtypi më 20.10.2009

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 36 lekë